



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje/Department of Education

Nr. 05/ 697

Datë: 18.08.2025

Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës si dhe vendimin nr. 290/01B të datës: 22.10.2012 (Korrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës, është i kompletuar dhe i zbatueshëm për arsimin parauniversitar të Kosovës), Drejtoria për Arsim e Komunës së Shtimes shpall:

K O N K U R S

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10-të) në arsimin e mesëm të lartë për vitin shkollor 2025/2026, në Gjimnazin "Naim Frashëri" dhe në Institucionin për Arsim dhe Aftësim Profesional në Shtime për afatin e gushtit

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe IAAP për vitin shkollor 2025/26, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen të bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron),
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2025/2026, bëhet më datën **19, 20, dhe 21 gusht 2025** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 08.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse më datën **22.08.2025**.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimi të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | | |
|---|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%) **100** pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare për gjimnaze dhe shkolla të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9) pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40 për qind i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9) } \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë **20** pikë.

$$\text{Mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë max}$$

2. Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve
 - a) Gjinnazi i shkencave natyrore: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë
 - b) Gjinnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi
3. Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP
 - a) Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari: Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi
 - b) Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehtari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion Kimi-Teknologji, PTT:

- Matematikë, TIK, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi
- c) **Ekonomi, administratë:**
Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi
- d) **Juridik dhe administratë:**
Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjeografi
- e) **Tregti, Hoteleri dhe Turizëm**
Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Edukatë qytetare, Gjeografi

4. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjimnazi i shkencave natyrore** – Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40 % të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)

$$\frac{\text{mes (Kimi)} + \text{mes (biologji)} + \text{mes (fizikë)} + \text{mes (matematikë)}}{4} \geq 4$$

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore** – Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40 % të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi)

$$\frac{\text{mes (Gjuhë shqipe)} + \text{mes (gjuhë angleze)} + \text{mes (histori)} + \text{mes (gjeografi)}}{4} \geq 4$$

- **Shkolla e shëndetësisë-** Mesatarja e lëndëve: kimi, biologji, fizikë dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)

$$\frac{\text{mes (kimi)} + \text{mes (g)} + \text{mes (fizikë)} + \text{mes (Gjuhë shqipe)}}{4} \geq 4$$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjuhë			
1.	Gjuhë shqipe	20 pikë	
2.	Gjuhë angleze	5 pikë	(gjithsej 25 pikë)
II. Shkencat shoqërore:			
1.	Gjeografi	12 pikë	
2.	Histori	13 pikë	(gjithsej 25 pikë)
III. Matematikë			
1.	Matematikë	20 pikë	
2.	Informatikë	5 pikë	(gjithsej 25 pikë)

IV. Shkencat natyrore

- | | | |
|-------------|--------|--------------------|
| 1. Fizikë | 8 pikë | |
| 2. Kimi | 8 pikë | |
| 3. Biologji | 9 pikë | (gjithsej 25 pikë) |

5. Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi shkencat e natyrës:

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Matematikë dhe informatikë 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| Totali | = 40 pikë |

II. Gjimnazi shoqëror dhe gjuhësor:

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------|
| 1. Shkenca shoqërore 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe informatikë 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| Totali | = 40 pikë |

6. Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP:

I. Shëndetësi, bujqësi dhe veterinari

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------|
| 1. Shkencat natyrore 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe informatikë 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| Totali | = 40 pikë |

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehtari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi- Teknologji

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Shkenca natyrore 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca shoqërore 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| Totali | = 40 pikë |

III. Ekonomi

- | | |
|----------------------------------|---------------------------|
| 1. Matematikë dhe informatikë 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
|----------------------------------|---------------------------|

2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 3. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 4. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
Totali= 40 pikë

IV. Juridik:

1. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.8 = 20$ pikë
 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 3. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 4. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë

Totali = 40 pikë

V. Tregti, Hoteleri dhe Turizëm:

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.8 = 20$ pikë
 2. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 3. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 4. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

VI. Shkollat Artistike

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.8 = 20$ pikë
 2. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 3. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 4. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

**PLANIFIKIMI PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR
 2025/2026 PËR AFATIN E GUSHTIT**

Gjimnazi “Naim Frashëri”

Shkolla	Drejtimi	Paralele	Nx. të planifikuar për regjistrim
Gjimnazi “Naim Frashëri” Shtime	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	4	59
	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	3	63
Gjithsej:		7	122

Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Shtime

Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve
Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional-Shtime	Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	1	6
		Automekanik	1	12
		Informatikë	1	8
	Agrokulturë, pylltari, peshatari dhe vetrinari	Agrobiznes	1	15
	Ekonomi, administrim dhe juridik	Banka dhe sigurime	1	8
		Kontabilitet	1	6
	Shëndetësi	Bashkëpunëtor profesional i infirmierisë	1	7
	Gjithsej:		7	62



Drejtoresha e DKA-së
Yllka Fejzullahu